

## AKT - THEMELIMI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### "RINOR CREATIONS" SHPK

##### NENI 1 - EMËRTIMI I SHOQËRISË

Prej shtetasit Kosovar :

PETRIT HAJDARI lindur në BEC, Kosovë më 04.03.1973 dhe banues në adresën: BEC me kombësi dhe shtetësi KOSOVARE.

Është Themeluar sot në datë 25.11.2024 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur:

**"RINOR CREATIONS"**

##### NENI 2 - QENDRA E SHOQËRISË

Shoqëria "RINOR CREATIONS" SHPK do të ketë qendrën në Vlorë në adresën: Vlorë, Zona Kadastrale nr. 3140, Numri i Pasurisë 381/8+1-15, Vlorë dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

##### NENI 3 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është në LEKË 500,000 (pesëqindmijë lekë) dhe është tërësisht kapital financiar i ortakut themelues në raportin 100%.

1. PETRIT HAJDARI kontribuon në shumën 500,000 lekë, pra 1 kuotë në raportin 100 %.

Me vendim të asamblesë së ortakëve kapitali i shoqërisë mund të rritet në mënyrat e parashikuara ligjore.

##### NENI 4 - KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë 10 vjeçare. Ajo do të jetë subjekt i së drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj deri më 25.11.2034. Shoqëria mund të shkrihet vetëm me vendim të ortakëve.

## NENI 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do ketë objekt të veprimtarisë së saj aktivitetet vijuese:

5.1 Shërbime dhe investime në pasuri të paluajtshme.

5.2 Shitje, blerje Pasuri të Paluajtshme.

5.3 Aktivitet në fushën e shërbimeve marketing, shërbime publiciteti, shitblerje për llogari të të tretëve.

5.4 Shoqëria ka si objekt dytësor dhe/ose plotësues, promovimin e Shqipërisë jashtë vendit dhe ofrimin e konsulencës tregtare e teknike dhe mbështetjen e nevojshme për sipërmarrësit apo kompanitë e huaja që synojnë të investojnë në Shqipëri.

Aktivitetet tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë dhe me pakicë. Shoqëria mund të kryejë

të gjitha veprimet tregtare, industriale, të luajtshme, të paluajtshme dhe të kryejë

çfarëdo lloji aktiviteti tjetër të lejuar që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e objektit

të aktivitetit të shoqërisë. Gjithashtu, shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri dhe/ose

ndërmarrje të çdo natyre që kanë objekt të njëjtë apo që lidhet me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

## NENI 6 - ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqërisë duke filluar nga data e sotme do të jetë PETRIT HAJDARI me letërnjoftim Nr. P01599534 dhe nr. personal 1500054057.

Shoqëria "RINOR CREATIONS" SHPK do të jetë subjekt i së drejtës shqiptare dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej ortakut themelues në datë 25.11.2024.

ORTAKU THEMELUES/ PETRIT HAJDARI



Vlorë, më 25 NËNTOR 2024 (dymijë e njëzetë e katër)